

V E N D I M
Nr.27, datë 20.1.2001

**PËR VENDOSJEN E KUTIVE POSTARE NË NDËRTESA BANIMI DHE NË
INSTITUCIONE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 6 të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999, "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Vendosjen e kutive postare në të gjithë projektet për ndërtesat e reja, objekte banimi, institucione social-kulturore dhe ente prodhuese.

Kutitë postare dhe lloji i tyre të vendosen nga vetë investitorët, në varësi të funksionit të ndërtesës.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punëve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta